


Udhëzues i përdorimit për Interna

Procesi i Regjistrimit


Hapi i parë

Tek ballina e faqes në anën e djathtë lartë klikoni tek butoni **Regjistrohu**, më pas zgjedhni opsionin **Praktikant/e** në listë.




Hapi i dytë

Në faqen e regjistrimit do të ju kërkohet që ti plotësoni të dhënat tuaja personale. Ato fusha të cilat kanë këtë "*" shenjë duhet të plotësohen gjithësesi për tu regjistruar. Së fundi klikoni në "Termat dhe kushtet" dhe pasi ti keni lexuar ato, klikoni "Pajtohem" dhe pastaj klikoni "Regjistrohu".

A screenshot of the registration form. It contains several input fields: 'Ngarko foton (Jo e detyrueshme)' with a placeholder 'Kliko për ta ngarkuar foton'; 'Përkatësia etnike *' with a dropdown menu 'Zgjedhni përkatësinë etnike'; 'Gjuhët *' with a '+ Shto Gjuhët' button; 'Edukimi *' with a '+ Shto edukimin' button; 'Eksperienca' with a '+ Shto Eksperienca' button; 'A keni vështirësi të vazhdueshme me shëndetin fizik ose mendor në ndonjë nga fushat e mëposhtme? *' with a dropdown menu 'Zgjedhni Opsionin'; and 'Si jeni informuar për programin e punës praktike Kosovo Generation Unlimited? *' with a dropdown menu 'Zgjedhni Opsionin'. At the bottom right, there is a checked checkbox for 'Termat dhe Kushtet' and a blue 'REGJISTROHU' button.


Hapi i tretë

Kontrolloni email adresen tuaj për të konfirmuar regjistrimin. Në email do të keni mundësi të kryeni konfirmimin nga laptopi juaj ose telefoni. Pasi të klikoni “**Këtu**” ju tashmë keni përfunduar procesin e regjistrimit dhe do të kaloni tek profili juaj në platformën **KosovoGenu**.



Si të kërkonit shpallje dhe trajnime?


Shpalljet dhe trajnimet mund ti shikoni në dy mënyra, nga ballina kryesore duke klikuar te “**Shpalljet**” apo tek menu-ja e profilit te “**Shpalljet**”



Në mënyrë që të gjeni më shpejtë atë se cka jeni duke kërkuar, ju keni mundësi të filtronit kërkimin në bazë të **vendit**, **trajnit**, **fushës së interesit**, **shkathtësive**, dhe **gjuhës**.


Nëse po kërkonit mundësi praktike të cilat përfshijnë edhe trajnim, shiko për shpallje të cilat kanë të vendosur shenjën “**+ Trajnim**”, këtë mund ta bëni gjithashtu duke filtruar shpalljet në bazë të

opsionit “Përfshin trajnim” te filtri i Trajnimit.



Si të aplikoni?

Për të aplikuar në një mundësi praktike, shkoni te “**Shikoni Detajet**” te shpallja e caktuar. Aty mund ti lexoni të gjitha detajet rreth shpalljes si dhe të aplikoni përmes butonit “**Apliko Tani**”. Në momentin e aplikimit detajet e **CV-së** tuaj të gjeneruar nga platforma do ti dërgohen punëdhënësit. Para aplikimit sigurohuni që ti keni përditësuar të dhënat në profilin tuaj.



Në rastin e pranimit në punën praktike, ju do të njoftoheni përmes **email** dhe **aplikacionit**. Për të

parë aplikimet tuaja, detajet e praktikës (në qoftë se keni) dhe ndryshoni të dhënat tuaja, shkoni te **Profili** juaj.

